

KARTA E QYTETARISË DEMOKRATIKE NË SHKOLLË

Shkolla i beson komunitetit misionin për të ndarë vlerat e demokracisë dhe për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës, të sigurt e frymëzues.

1 Liria e mendimit dhe shprehjes ushtrohet me përgjegjshmëri dhe në respekt të vlerave demokratike.

2 Shkolla garanton barazinë e plotë, veçanërisht ndërmjet vajzave dhe djemve, dhe kundërshton çdo formë diskriminimi.

PARIMET THEMELORE

3 Refuzohet çdo formë e dhunës dhe e bullizmit në mjedisin shkollor.

4 Promovohet një kulturë e respektit, tolerancës dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

5 Shkolla siguron një mjedis të sigurt fizikisht, të shëndetshëm emocionalisht dhe stimulues intelektualisht.

6 Çdo nxënës ka të drejtë të marrë pjesë aktivisht, të shprehë mendimet dhe të dëgjohet pa paragjyime.

7 Shkolla mbështet dhe fuqizon zërin e nxënësve në vendimmarrje, veçanërisht të atyre nga grupet e cenueshme.

8 Shkolla kultivon mendimin kritik, analitik dhe kreativ tek të gjithë nxënësit.

PJESËMARRJA DHE KOMPETENCAT DEMOKRATIKE

9 Inkurajohet zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve përmes dialogut, kompromisit dhe bashkëpunimit.

10 Nxitet puna vullnetare, aktivizmi për të drejtat e njeriut dhe zhvillimi i pasioneve përmes klubeve të shkollës (debat, art, sport, etj.).

11 Të gjithë anëtarët e komunitetit, stafi dhe nxënësit, zotohen të respektojnë rregulloren dhe të angazhohen me përgjegjshmëri.

12 Forcohet bashkëpunimi në trekëndëshin nxënës-mësues-prind si shtylla bazë e komunitetit të shkollës.

JETA DHE ANGAZHIMI NË SHKOLLË

13 Qeveria e Nxënësve është promotori kryesor dhe mbikëqyrësi i zbatimit të kësaj Karte.

14 Nxënësit marrin pjesë aktive në fushatat sensibilizuese për parandalimin e dukurive negative.

15 Kjo Kartë është një dokument i gjallë, i cili njihet nga të gjithë, zbatohet dhe rishikohet periodikisht nga komuniteti.